

Nr. 1094/prot.

3

Urë Vajgurore, më 30.04.2024

VENDIM

Nr. 22 Datë 30.04.2024

“Për miratimin e përdorimit të fondit të ndihmës ekonomike, nga fondet e Bashkisë sipas listës emërore bashkëlidhur, për 121 familje me fond prej 341.000 lekë, për muajin Mars 2024”.

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike, në mbështetje Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, VKM Nr.955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit, dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar 6%” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; në mbështetje të Udhëzimit Nr.8, datë 08.05.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr.3 datë 17.02.2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” Udhëzimi Nr.4 datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, VKB Nr. 52, datë 26.12.2023 “Për miratimin e programit Buxhetor afatmesëm 2024 – 2026 dhe detajimin e buxhetit për Vitin 2024.

VENDOSI :

Me 17 vota PRO, nga 17 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të ndihmës ekonomike, nga fondet e Bashkisë sipas listës emërore bashkëlidhur, për 121 familje me fond prej 341.000 lekë, për muajin Mars 2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

AVDULLA SALILLARI